

20060330385

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E
TOPOGRAFISË SË QARQEVE INTEGRALE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e topografisë së qarqeve integrale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 5/98) në nenin 5 fjalët: “Enti për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale” zëvendësohen me fjalët: “Enti Shtetëror për Pronësinë Industriale”.

Neni 2

Në nenin 6 paragrafi (2) fjalët: “ministri i Zhvillimit”, zëvendësohen me fjalët: “komisioni kompetent i shkallës së dytë pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë”.

Neni 3

Në nenin 12 paragrafi (4) fjalët: “ministri i Zhvillimit”, zëvendësohen me fjalët: “drejtori i Entit”.

Neni 4

Neni 18 ndryshohet si vijon:

“Dispozitat për përfaqësimin dhe përfaqësimin e të huajve, përbërja e Komisionit sipas ankesës së Qeverisë të Republikës së Maqedonisë, arritshmëria e dokumentacionit dhe informacioneve të Entit, mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjes, afatet për vazhdimin e procedurës, arritshmëria e dokumentacioneve dhe informatave të Entit, shënimi i ndryshimeve në regjistrat, dispozitat e përgjithshme për mbrojtjen gjyqësore, masat e sigurimit, transferimi i të drejtave dhe marrëveshja për licencë, të shpallurit të pavlefshëm të aktvendimit për pranimin e të drejtave nga pronësia industriale dhe mbikëqyrja inspektuese nga Ligji për pronësi industriale, do të zbatohen edhe mbi topografitë e qarqeve integrale”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.